

KOLEGJI AAB
FAKULETI EKONOMIK
STUDIMET MASTER
PRISHTINË



PUNIM MASTERI

Tema:

**“Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
dhe Roli i saj në Kosovë”**

Kandidati:
Shpend Haziri

Mentori:
Prof. Dr. Albulenë Kastrati

Prishtinë, 2019

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: 038/ 601 019; 038/ 601 020, Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666, 044/ 522 588, info@universitetiaab.com www.universitetiaab.com

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është që të njihemi më shumë me historinë e formimit dhe zhvillimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), evoluimin e saj, procesin e funksionimit të sistemit bankar të saj, mënyrës se si banka financon projektet dhe ndikimin e saj në zhvillimin ekonomik të një vendi, përkatesisht Kosovës.

Pra, synimi i BERZH është që të promovohet një ekonomi funksionale e tregut, ku bizneset konkurrojnë me njëra tjetrën, ku inkurajohet inovacioni si dhe të hyrat reflektojnë rritje të punësimit, produktivitetit dhe mirqenjen e popullsisë.

Ky hulumtim është zhvilluar në baze të literaturës së gjere vendore dhe të huaj, janë përdorur një sërë metodash kërkimi dhe studimi mbi identifikimin e kritereve që bankat i aplikojnë për lejimin e kredive, për vlerësimin e aftësive kreditore të huamarrësve dhe fushën në të cilën kreditohet. Hulumtimi gjithashtu është bazuar në të dhënat nga akterët me ndikim botëror në çështjet ekonomike, të tillë si Banka Botërore, EBRD, FMN etj

Në këtë studim përfshihet Ballkani Perëndimor dhe në veçanti analizohet ndikimi i investimeve të BERZH në Kosovë, të dhënat përfshijnë periudhën 2008-2017 gjendjen para dhe pas antaresimit të Kosovës në BERZH. Ndërsa me theks të veçantë është trajtuar ndikimi i BERZH në zhvillimin dhe operimin e NVM-ve në Kosovë dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Ky hulumtim është i orientuar drejt studimit të fushave/projekteve të financuara nga BERZH-i në shtetet anëtare të saj, dhe planet për zhvillimin ekonomik të Kosovës, analizimi i fushave dhe projekteve konkrete ku Kosova do të mund të përfitonte tashmë si anëtare e BERZH-it si një nga investitorët me të mëdhenjë në regjion.

ABSTRACT

Intention of this preparation is that we to know more regarding history of forming and developing of The European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), evaluation of it ,process of their bank system functioning, way of financing projects and impact on development of Economic system to one country, on this case Kosovo.

Goal of EBRD is to promote one functioned economy of trade, where business competes with each other, where they are encouraged to make innovations and increase of turnover, which will reflect increase of employment, productivity and welfare of population.

This research has been developed on the basis of extensive domestic and foreign literature, a number of research methods and studies are used to identify the criteria that banks apply for credit granting, for evaluating of borrowers and in field where they are borrowed. The survey was also based on data from world-influential actors in economic issues, such as the World Bank, EBRD, IMF etc.

This study includes the Western Balkans and in particular analyzes the impact of EBRD investments in Kosovo, data include the period 2008-2017 before and after the accession of Kosovo to EBRD. While with particular focus is addressed the EBRD's impact on the development and operation of SMEs in Kosovo and the opening of new jobs.

This research is oriented towards studying EBRD-funded areas / projects in its member states, plans for Kosovo's economic development, analyzing concrete areas and projects where Kosovo could now benefit as a member of EBRD, as one of the largest investors in the region

Përfundimi

Megjithëse rritja ekonomike e Kosovës ka tejkaluar fqinjët e saj dhe ka qene kryesisht e qendrueshme, kjo nuk ka qene e mjaftueshme per te reduktuar normat e larta te papunesise, veqanarisht per grate dhe te rinjte, ose te ndryshoj prirjen e largimit ne mase te madhe te popullsis nga vendi, ndersa Kosova vazhdon te mbetet në një pozitë të palakmueshme për të bërë biznes, kjo per shkak te mungesës se një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik. Duke filluar nga niveli i lartë i korrupsionit, normat e larta të interesit, mungesa e vizionit për krijimin e një strategjie në krijimin e burimeve për energji të ripërtërishme, orientimi i investimeve në infrastrukturë rrugore dhe lënia anash e investimeve në hekurudha tregojnë një ambient te papershtatshem dhe jo premtues për rritje ekonomike.

Kosova me 17 dhjetor 2012 u be shteti anetar i BERZH-it i 66 me radhe dhe qe nga ajo kohe BERZH vazhdon te mbetet investitori me i madhe deri me tani ne vendin tone me rreth miliarde euro te investuara ne sektorin privat dhe publik. Synimet e kesaj banke per Kosoven mbeten funksionalizimi i tregut permes investimeve te orjentuara drejt sektorit privar perkatesisht transport, energji, agrobiznes.

Strategjia e tanishme e rritjes dhe reduktimit të varfërisë në Kosovë duhet të adresojë ngërçet e infrastrukturës, veçanërisht në energji, të krijojë një ambient më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat, te siguroj nje ambient te qendrueshem afarist, pajisja e popullatës së re me aftësitë e kërkuara nga punëdhënësit, të sigurojë mbrojtje financiare për qytetarët për të arritur rezultate më të mira shëndetësore, dhe të ndërtojë qeverisjen dhe sundimin e ligjit për të përfituar plotësisht përfitimet nga integrimi në BE, të nxjerrin fitimet e produktivitetit dhe të krijojnë vende pune cilësore që nxisin përfshirjen. Boshllëqet gjinore në qasjen ndaj mundësive ekonomike mbeten një nga sfidat kryesore për Kosovën.